



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË  
KËSHILLI I BASHKISË**

**INFORMACION PËR VENDIMARRJEN DHE PERFORMANCËN E KËSHILLIT TË  
BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2022**

**Të nderuar!**

Këshilli i Bashkisë Korçë për vitin 2022 ka pasur një aktivitet të plotë në vendimarrje dhe në komunikim të vazhdueshëm me komunitetin. Kemi mundur të arrijmë disa objektiva madhore në kryerjen e funksioneve duke u mbështetur te ligji 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe legjislatiioni sektorial për fusha të ndryshme të vetëqeverisjes vendore.

Duke pasur parasysh se shumë aktivitete të zhvilluara bëjnë pjesë në më shumë se një nga rolet e mësipërme të Këshillit po mundohemi në mënyrë të përmbledhur të japim aktivitete kryesore të zhvilluara sipas kategorive.

Në lidhje me rolin vendimarrës, janë kryer kryesisht aktivitetet si më poshtë:

Gjatë vitit 2022 janë realizuar në total 17 mbledhje të Këshillit, 12 prej tyre të radhës dhe 5 jashtë radhe me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë.

Në total janë miratuar 177 vendime prej të cilave 1 të pa konfirmuara nga institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë. Nga vendimet e pakonfirmuara, 1 vendim është rikonfirmuar nga Këshilli duke u lënë në fuqi. Janë realizuar mbledhje komisioneve sipas materialeve përkatëse.

Për shkak të karakterit emergjent të materialeve, këtë vit janë zhvilluar 5 mbledhje on-line dhe 12 mbledhje me takime fizike në sallë. Duhet theksuar që të gjitha mbledhjet e Këshillit janë zhvilluar në transmetim live nëpërmjet faqes së Facebook, çka ka bërë që komuniteti të ndjekë direkt mbledhjen madje të japë dhe mendimet dhe sugjerimet e tij për vendimet dhe çështjet që janë shqyrtuar.

Gjithashtu gjatë vitit 2022 kemi miratuar një plan aktivitetesh të shoqëruar me buxhetin përkatës të dedikuar vetëm për Këshillin në mënyrë që të realizoheshin aktivitetet e planifikuara.

Në procesin e implementimit dhe zbatimit të rregulloreve Këshilli është asistuar nga Projekti “Bashki të Forta” i cili do vazhdojë edhe për këtë vit të asistojë për të bërë të mundur vazhdimin e implementimit të këtyre standarteve në mënyrë që të rritet roli i Këshillit të Bashkisë.

Në lidhje me rolin përfaqësues të Këshillit për vitin 2022, është synuar që komunikimi dhe marrja e mendimeve të komunitetit të realizohet nëpërmjet komunikimit kryesisht nëpërmjet



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KORÇË**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

publikimit dhe marrjes së mendimeve nëpërmjet rrjeteve sociale por edhe në takime të përbashkëta me ekzekutivin, si buxhetimi me pjesëmarrje. Për këtë qëllim faqja e Facebook-ut e Këshillit Bashkiak Korçë e cila ka qënë aktive që në vitin 2020, ka publikuar vazhdimisht aktivitetet të Këshillit dhe realizuar transmetimin livestream të mbledhjeve, gjë e cila, tashmë është pjesë e procedurave të zhvillimit të mbledhjeve.

Në faqen Facebook kanë erdhur shumë mendime dhe sugjerime nga komuniteti. Anëtarët e KB, janë fokusuar gjithashtu edhe në takimet direkte me banorët e Bashkisë Korçë dhe përcjelljen e mendimeve të tyre në mbledhjet e komisioneve dhe të KB..

Në zbatim të rregulloreve të miratuara është vënë në funksionim regjistri fizik i ankesave/kërkesave dhe një regjistër fizik i iniciativave/peticioneve ku regjistrohen dhe evidentohen të gjitha ankesat/kërkesat e mbërritura në drejtim të Këshillit të Bashkisë. Konkretisht janë depozituar në total rreth 30 kërkesa drejtuar Këshillit Bashkiak. Janë trajtuar në bashkëpunim me ekzekutivin 30 kërkesa dhe në të gjitha rastet janë informuar qytetarët.

Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit, përveç ushtrimit të këtij roli nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve të ezauara nga ana e këshilltarëve në drejtim të administratës me rastin e shqyrtimit të gjithë projekt-vendimeve të propozuara nga ekzekutivi, në zbatim të planit të aktiviteteve të vitit 2022 u realizuan dhe u paraqitën në Këshill 15 informacione dhe raporte nga administrata sipas kërkesave të bëra dhe nga vetë Këshilli.

Në këtë drejtim, edhe gjatë vitit 2023, do të vijojë një bashkëpunim edhe më i mirë me administratën dhe një angazhim më i madh për ekzekutivin, për përgatitjen në kohë të raporteve dhe informacioneve e planifikuara në planin e aktiviteteve të Këshillit, por edhe rast pas rasti, sipas kërkesës së KB.

Nga sa më sipër, duke ju falenderuar secilin për kontributin dhe angazhimin, si dhe duke falenderuar projektin “Bashki të Forta”, për bashkëpunimin dhe asistencën për aktivitetin e Këshillit të Bashkisë Korçë, ju ftojme të bëheni pjesë, për përmirësimin e punës së Këshillit nëpërmjet mendimeve dhe sugjerimeve tuaja.

Faleminderit!